

LIGJ
Nr. 88/2023

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE, ME SHKËMBIM NOTASH,
TË MARRËVESHJES SË PARTNERITETIT, TREGTISË DHE BASHKËPUNIMIT
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË BASHKUAR
TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT,
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 31/2021**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese, me shkëmbim notash, e marrëveshjes së partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, ratifikuar me ligjin nr. 31/2021, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.11.2023.

Shpallur me dekretin nr. 335, datë 23.11.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Bajram Begaj.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRI**

Nr. 6187 / Prot.
7

Tiranë, më 12 / 6 2023

SH.T.Z. Alastair King-Smith

Ambasador i Madhërisë së Tij

Ambasada Britanike

Tiranë

**SHKËMBIM NOTASH PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES SË
PARTNERITIT, TREGTISË DHE BASHKËPUNITIT MIDIS REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË TË MADHE
DHE IRLANDËS SË VERIUT BËRË NË TIRANË MË 5 SHKURT 2021**

Shkëlqësia Juaj,

Kam nderin të pranoj marrjen e notës tuaj të datës 12 janar 2023 në lidhje me Marrëveshjen e Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, bërë në Tiranë më 5 shkurt 2021 ("Marrëveshja"), e cila thotë si më poshtë:

"Letra Fillesatare/ MB

Shkëlqësia Juaj,

Kam nderin t'i referohem Marrëveshjes së Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Republikës së Shqipërisë, bërë në Tiranë më 5 shkurt 2021 ("Marrëveshja"), dhe diskutimeve të fundit të cilat janë zhvilluar ndërmjet përfaqësuesve të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë lidhur me ndryshimin e disa dispozitave të Marrëveshjes.

Në përputhje me këto diskutime të fundit, dhe në përputhje me nenin 11 të Marrëveshjes, kam nderin të propozoj në emër të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut që Marrëveshja të ndryshohet duke futur sa vijon pas nenit 74(5) të Marrëveshjes të përfshirë, si nen të ri 74(6):

' 74 (6). Ky nen nuk do të zbatohet për prokurimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor klinik të financuara nga fonde publike. Shërbimet e kujdesit shëndetësor klinik përfshijnë shërbimet e mëposhtme:

(a) Shërbimet e shëndetit të njeriut (CPC 931);

(b) Shërbimet e kujdesit shëndetësor administrativ (CPC 91122); dhe

(c) Shërbimet e furnizimit të personelit infermier dhe shërbimet e furnizimit të personelit mjekësor (CPC 87206 dhe CPC 87209).

CPC nënkupton Klasifikimin Qendror të Produkteve siç përcaktohet në Zyrën Statistikore të Kombeve të Bashkuara, Dokumentet Statistikore, Seria M, N° 77, CPC prov, 1991.'

Nëse propozimi i mësipërm është i pranueshëm për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, unë propozoj që kjo notë dhe përgjigja juaj për këtë bërë në gjuhën angleze dhe shqipe, duke qenë të dy tekstet me të njëjtën vlerë, së bashku do të përbëjnë një marrëveshje ndërmjet dy qeverive tona në këtë çështje, e cila do të hyjë në fuqi në një datë që do të përcaktohet nga Palët në një shkëmbim të mëtejshëm të notave që konfirmojnë përfundimin e procedurave të tyre të brendshme përkatëse.

Përfitoj nga ky rast për t'i ripërtërirë Shkëlqesisë Suaj sigurinë e konsideratës sime më të lartë."

Kam nderin të konfirmoj se propozimi i sipërpërmendur është i pranueshëm për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe se nota juaj dhe kjo përgjigje së bashku do të përbëjnë një marrëveshje ndërmjet dy qeverive tona për këtë çështje, e cila do të hyjë në fuqi në një datë që do të përcaktohet nga Palët në një shkëmbim të mëtejshëm të notave që konfirmojnë përfundimin e procedurave të tyre të brendshme përkatëse.

Përfitoj nga ky rast për t'i ripërtërirë Shkëlqesisë Suaj sigurinë e konsideratës sime më të lartë.

E Jura Sinqerisht,

Delina Ibrahimaj

Ambasada Britanike
Tiranë

Rruga Skënderbej
Tiranë, Albania
Tel: +355 69 202 3058
E-mail: Alastair.King-Smith@fcdo.gov.uk
Twitter: @alastairks

Nga Ambasadori Britanik
Sh. S. Znj. Delina Ibrahimaj
Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Tiranë, 12 janar 2023

SHKËMBIM NOTASH
PËR NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES SË PARTNERITETIT, TREGTISË DHE
BASHKËPUNIMIT NDËRMJET MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË
MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, BËRË NË
TIRANË NË DATËN 5 SHKURT 2021

Shkëlqesia Juaj,

Kam nderin t'i referohem Marrëveshjes së Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Republikës së Shqipërisë, bërë në Tiranë më 5 shkurt 2021 ("Marrëveshja"), dhe diskutimeve të fundit, të cilat janë zhvilluar ndërmjet përfaqësuesve të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë lidhur me ndryshimin e disa dispozitave të Marrëveshjes.

Në përputhje me këto diskutime të fundit dhe me nenin 11 të Marrëveshjes, kam nderin të propozoj në emër të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut që Marrëveshja të ndryshohet, duke përfshirë sa vijon pas nenit 74(5) të Marrëveshjes të përfshirë, si nën të ri 74(6):

"74(6) Ky nen nuk do të zbatohet për prokurimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor klinik të financuara nga fonde publike. Shërbimet e kujdesit shëndetësor klinik përfshijnë shërbimet e mëposhtme:

- a) Shërbimet e shëndetit të njeriut (CPC 931);
- b) Shërbimet e kujdesit shëndetësor administrativ (CPC 91122); dhe
- c) Shërbimet e furnizimit të personelit infermieror dhe shërbimet e furnizimit të personelit mjekësor (CPC 87206 dhe CPC 87209).

CPC-ja nënkupton Klasifikimin Qendror të Produkteve, siç përcaktohet në Zyrën Statistikore të Kombeve të Bashkuara, Dokumentet Statistikore, Seria M, N°77, CPC prov, 1991."

Nëse propozimi i mësipërm është i pranueshëm për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, propozoj që kjo notë dhe përgjigja juaj për këtë qëllim, bërë në gjuhën angleze dhe shqipe, duke qenë të dyja tekstet me të njëjtën vlerë, së bashku do të përbëjnë një marrëveshje midis dy qeverive tona në këtë çështje, e cila do të hyjë në fuqi në një datë që do të përcaktohet nga Palët në një shkëmbim të mëtejshëm të notave që konfirmojnë përfundimin e procedurave të tyre të brendshme përkatëse.

Përfitoj nga ky rast për t'i përsëritur Shkëlqesisë Suaj sigurinë e konsideratës sime më të lartë.

Me respekt,
Nënshkrimi
Alastair King -Smith

